



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Nr. 56/2020
Datë: 20.05.2020

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë, bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr. 05/L -031 - Për procedurën e përgjithshme administrative, nenin 38 të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve medicinale, në takimin e mbajtur me datë 20.05.2020, me rastin e shqyrtimit të kërkesës me Nr.56, të datës 04.05.2020 , nga Kompania **Lek Sandoz** , me seli në Prishtinë, me adresë: Mati 1, Rruga B, me person përgjegjës **Krenar Jëlliqi**, të ushtruar kundrejt vendimit të komisionit për çmime të datës 23 Mars të publikuar, nxjerr:

V E N D I M

HUDHET POSHTË si e pa afatshme, kërkesa për rishqyrtimin e çmimeve e parashtruar nga Kompania **Lek Sandoz** me seli në Prishtinë, adresa Mati 1 rruga B .

Arsyetimi

Komisioni për Përcaktimin e Çmimeve të Produkteve Medicinale, konstatoi se vendimi për përcaktimin e çmimeve është publikuar me datë 23.03.2020, afati i ankesave ka qenë 8 ditë nga data e publikimit të listës së çmimeve, që i bie deri me datën 31.03.2020 ndërsa ankesa e palës është pranuar me datë 04.05.2020, jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë të ankesë në Komisionin e Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë, në afat prej 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit të vendimit.

Dr. Naim Bardhi

Kryesues i Komisionit

Vendim i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. AKKPM-së

